



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.  
2018

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË**

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 02.11.2018

Për: **Operatorin Ekonomik “ARENA MK” shpk, me NIPT L67619801Q, me adresë Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Ndërtesa private Nr.2, Zona kadastrale 1566, Nr.pasurie 93/14, Qendër Dukas, Mallakastër.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-82816-08-14-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mbikqyrje objekti: Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Besëlidhja”, qyteti Ballsh”, me fond limit 1.217.265 (një milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, me afat 5 muaj.**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.33, datë 20 gusht 2018

Kriteret e për zgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. Operatori Ekonomik “ARENA MK” shpk, me NIPT L67619801Q, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 1.056.942 (një milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzetë e dy) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “REAN 95” shpk, me NIPT J61827043V, ka paraqitur ofertën



ekonomike në shumën 920.300 (nëntëqind e njëzet mijë e treqind) lekë pa TVSH.

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

#### **1. Operatori Ekonomik “REAN 95” shpk, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7 të dokumentave standarte të tenderit, pasi për të treja kontratat e mëparshme të ngjashme të realizuara me sektorin publik, nuk ka paraqitur vërtetimet për realizimin e këtyre kontratave.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “f”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi oferta e paraqitur është në një vlerë më të ulët sesa vlera minimale e lejuar në bazë të parashikimeve të VKM Nr.354 date 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“ARENA MK” shpk, me NIPT L67619801Q, me adresë Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Ndërtesa private Nr.2, Zona kadastrale 1566, Nr.pasurie 93/14, Qendër Dukas, Mallakastër**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1.056.942** (një milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzetë e dy) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **29.08.2018**

Ankesa: Për këtë procedurë ka paraqitur ankesë operatori ekonomik “Rean 95” shpk dhe pasi është shqyrtuar i është kthyer përgjigje në datën 04.09.2018. Procedura është mbajtur e pezulluar pasi Operatori ekonomik “Rean 95” shpk, ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin 735/2018 (regjistruar në protokollin hyrës të AK me nr.2493 regj, datë 02.11.2018), ka vendosur përfundimin e procedimit administrativ dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

### **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Agron Kapllanaj**

